



VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
 ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
 GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD,
 FERIZAJ / UROŠEVAC.

Më
 Dana

26-07-2018

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.2735/17

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, në përbërje nga gjyqtarja Hakile Ilazi, me zyrtaren ligjore Ganimete Avdiu, në lëndën penale kundër të akuzuarëve [REDACTED] për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 të KPRK-së, dhe [REDACTED] për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1586-5/17 e datës 30.10.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në prani të prokurorit të shtetit Sebahate Sinani, të akuzuarëve, mbrojtësit të të akuzuarit te parë av. [REDACTED] [REDACTED] i caktuar sipas detyrës zyrtare, me dt.21.12.2017, shpall dhe publikisht komunikon këtë:

A K T G J Y K I M

1. I akuzuari [REDACTED] nga [REDACTED] komuna Ferizaj, i lindur më [REDACTED] në Prishtinë, nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED], ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, me profesion saldues, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së mesme ekonomike, në arrest prej dt.22.08.2017 deri më 20.11.2017.
2. I akuzuari [REDACTED], nga Ferizaj, [REDACTED] i lindur më dt. [REDACTED] në Ferizaj, nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së mesme ekonomike.

Janë fajtorë

1. Artan Idrizi

Se me datën 22.08.2017, rreth orës 22.00, në [REDACTED] komuna Ferizaj, pas një mosmarrëveshje, që kishin ndërmjet veti i pandehuri deri sa ka qenë duke kaluar rrugës për të shkuar tek shtëpia e tij duke kaluar rreth shtëpisë së të dëmtuarit [REDACTED] [REDACTED] pasi që i dëmtuari i është drejtuar me fjalët “ Qka je duke lyp këtu pari” pas një fjalosje verbale, ku fillon rrahja , i pandehuri e godet me një guri, mjet ky i

përshatshëm për shkaktimin lëndimit të rëndë trupor në kokë ku si pasoj e kësaj goditje ka pësuar lëndime të lehta trupore [REDAKTUAR] dhe atë ndrydhje të indeve të buta në regjionin e kokës, plagë shyqese ndrydhëse në regjionin muror, të majtë dhe regjionin muroro-temblor të djathtë, me pasoja të përkohshme, në shëndet të përshkruara në ekspertizën mjeko-ligjore të dt.22.09.2017.

me të cilën ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 të KPRK-së.

2. [REDAKTUAR]

Se në kohë dhe vend të njejtë si në dispozitivin e parë të kësaj akuze, pas një mosmarrëveshje që kishin ndërmjet veti deri sa i dëmtuari [REDAKTUAR] ka qenë duke kaluar rrugës për të shkuar tek shtëpia e tij duke kaluar rrethe shtëpisë së të pandehurit [REDAKTUAR] pasi që i pandehuri i është drejtuar me fjalët “ qka je duke lyp këtu pari”, pas një fjalosje verbale e godet me duar-grusht në trup të dëmtuarin [REDAKTUAR] ku si pasoj e kësaj goditje i dëmtuari ka pësuar lëndime të lehta trupore, të përshkruara në ekspertizën mjeko-ligjore të dt.22.09.2017.

me të cilën ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata ne baze të neneve 4,6,17,23,41,51 dhe 73 të KPRK-së si dhe neni 365 të KPPK-së,

SHQIPTON:

Të akuzuarëve :

1. [REDAKTUAR] i cakton dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3/ tre /muaj/, ekzekutimi i të cilit do të bëhet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Ne dënimin e shqiptuar i llogaritet koha e kaluar në arrest shtëpie nga data 22.08.2017 deri 20.11.2017.

2. [REDAKTUAR] i cakton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2/ dy /muaj/ i cili dënim nuk do të ekzekutohet në rast se i akuzuari brenda 1/një/viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen veprë tjetër penale (koha e verifikimit).

Të dëmtuarit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohen të akuzuarit që në emër të paushallit gjyqësor, të paguajnë shumën secili veç e veç me nga 30 /tridhjetë/ €, si dhe shpenzimet e procedurës penale në mënyrë solidare prej 20 /njëzetë /€ në afat prej 30 ditësh, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

Arsyetimi

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën PP/II.nr.1586-5/17 e datës 30.10.2017, ka akuzuar të akuzuarit [REDAKTUAR] për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 të KPRK-së dhe [REDAKTUAR] për veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti shqyrtimin gjyqësor ku prokurorja është Sebbahate Sinani në fjalën përfundimtare mbeti në tersi pran akuzës dhe kualifikimit juridik të saj, duke i propozuar gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe të shqiptoj një sanksion penale të paraparë me ligje,

I akuzuari i parë [REDAKTUAR] në seancën fillestare nuk e ka pranuar fajësinë kurse në mbrojtjen e tij të dhen në shqyrtimin gjyqësor ka pranuar fajësinë për këtë veprë penale që e ngarkon akuza, po ashtu edhe mbrojtësi i tij av. [REDAKTUAR] sipas detyrës zyrtare, nuk e ka kundërshtuar pranimin e fajësisë për të akuzuarin dhe në konsultime të bollshme me mbrojtësin

e tij është deklaruar fajtor për veprën për të cilën e ngarkon akuza, duke e shprehur pendim real dhe të sinqertë për veprën penale të kryer, duke shtuar se është hera e parë që ka kryer vepër penale, i premtom gjykatës që ne te ardhmen nuk do të përsërisë vepra te tilla apo te ngjashme penale, i ka propozuar gjykatës që ti shqiptoj një dënim sa me te butë.

Pasi që i akuzuari ka pranuar fajësinë, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 326 lidhur me 248 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarit, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit dhe atë: CD, ekspertiza mjekoligjore e dt. 22.09.2017 si dhe fotografitë dhe shkresat tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Meqenëse i akuzuari ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj gjykata konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant dhe ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 të KPRK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK-ës dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese se i akuzuari ka pranuar fajësinë, duke e shprehur pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, dhe nuk është i njohur më parë si kryes i veprave penale, i gjendjes së varfër ekonomike, sjelljen korrekte gjatë tërë procedurës, si dhe në shqyrtimin gjyqësor, në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese, përveç që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është bindur se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me peshën e veprës penale, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe me dënimin e shqiptuar me kusht do të arrihet qëllimi i dënimit siç parashihet ne dispozitat e nenit 41 të KPRK-së, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen

(preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

I akuzuari [REDAKTUAR] në seancën fillestare nuk e ka pranuar fajësinë kurse në mbrojtjen e dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor ka theksuar se nuk është e vërtetë se e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barr, duke shtuar se [REDAKTUAR] personalisht [REDAKTUAR] nuk e kishte njohur por ne bazë te fjalëve te lagjes së tyre kishte dëgjuar se i njëjti është i njohur për kryerjen e veprave penale të vjedhjes duke dyshuar se i njëjti edhe ka ndonjë ekip te veten, dhe nuk e kishte parë ndonjëherë duke vjedhur. Ndërsa në natën kritike ne afërsi të shtëpisë së tyre kishte vrejtur [REDAKTUAR] së bashku me një person tjetër i cili kishte qene i moshës se mitur i cili ishte ne këmbë, i njëjti ne ato momente pasi që i kishte vërejtur qe janë dy persona te cilët ishin duke tentuar me hy ne shtëpinë time mbrapa shtëpisë, i njëjti kishte vrapuar ne drejtim te [REDAKTUAR] ku e kishte kapur për trenerke dhe ja kishte zdash trenerken dhe ne ato momente [REDAKTUAR] e kishte kapur një bllok dhe e kishte goditur ne koke, ndërsa personi tjetër kishte ikur prej vendit te ngjarjes, ndërsa ai ishte rrezuar ne toke dhe pastaj ishte ngrit në këmbë në drejtimin e shtëpisë së tij dhe nuk i kujtohet se ae kishte goditur [REDAKTUAR] duke konsideruar se nga goditja që kishte marr nga [REDAKTUAR] e kishte humbur vetëdijen dhe i njëjti lëndimet i kishte marrë përkatësisht në kokë nga [REDAKTUAR]

Nga dëshmia e dëshmitarit [REDAKTUAR] është vërtetuar se në ditën kritike ka qene ne shtëpi rrethores 22.00 së bashku me babain e tij dhe i njëjti pasi që kishte dëgjuar disa zëra kishte dal nga shtëpia te dyert e oborrit të shtëpisë se bashku me babain e tij me qe rast e kishte vërejtur vëllai i tij [REDAKTUAR] i cili kishte pësuar lëndime dhe pasi që ka qenë i shqetësuar kishte vrapuar mbrapa [REDAKTUAR] se bashku me babain e tij deri te shtëpia e [REDAKTUAR] por ne ato momente kishin arritur policia dhe nuk e kishte parë [REDAKTUAR] duke e sulmuar vëllaun e tij [REDAKTUAR] e po ashtu as [REDAKTUAR] nuk e kishte parë duke e goditur [REDAKTUAR]

Pasi qe i akuzuari [REDAKTUAR] nuk ka pranuar fajësinë gjykata ka bërë paraqitjen e provave dhe pas pas vlerësimit te tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht njërën me tjetrën konform nenit 387 par.2 te KPPK-se, vërtetoj gjendjen faktike të përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata gjendjen faktike e ka vërtetuar përmes provave të prezantuara në shqyrtimin gjyqësor dhe atë: pjesërisht nga mbrojtja e vetë të akuzuarit, mendimi i ekspertit të mjekësisë ligjore e dt. 22.09.2017 nga Dr. [REDAKTUAR]

Dëshminë e dëshmitarit [REDAKTUAR] gjykata e mori si të besueshme, pasi që i njëjti ka deklaruar se nuk e kishte parë asnjërin të akuzuar se kishte goditur njeri tjetrin.

Mbi gjendjen e tillë faktike të vërtetuar, gjykata vlerësoi se në veprimet e të akuzuarit [REDAKTUAR], ekziston të gjitha tiparet e kryerjes së veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 të KPRK-së.

Mbrojtja e të akuzuarit [REDAKTUAR] se nuk e ka goditur të akuzuarin [REDAKTUAR] dhe nuk i kujtohet pasi që nga goditja që kishte marr nga [REDAKTUAR] nuk i kujtohet se të njëjtin e ka goditur, gjykata e vlerëson si të pa bazuar, dhe se një mbrojtje e tillë është orientuar në drejtim të justifikimit të veprimit të tij inkriminues.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit konform nenit 73 të KPRK-së, Gjykata vlerësoj rrethanat lehtësuese dhe rënduese dhe gjeti si rrethanë lehtësuese se i akuzuari [REDAKTUAR] se nuk është i njohur për kryerjen e veprave penale të tilla apo të ngjashme, kurse nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese përveç që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të tij si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit përkatësisht qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 41 të KPRK-ës, dhe me këtë dënim të shqiptuar që është në proporcion me peshën e veprave penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve rrethanat e kryerjes, se edhe me anë të këtij dënimi me gjobë, do të arrihet qëllimi i dënimit, parandalimi i kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen si dhe do të arrihet edhe qëllimi tjetër që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale.

Konform nenit 458 dhe 459 të KPRK-së, i dëmtuari [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR] Komuna Ferizaj për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil

Konform nenit 456 të KPPRK-së, obligohen te akuzuarit që në emër të paushallit gjyqësor, te paguajnë shumën secili veç e veç me nga 30 /tridhjetë/ €, si dhe shpenzimet e procedurës penale në mënyrë solidarë prej 20 /njëzetë /€ në afat prej 30 ditësh, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ


P.nr.2735/17 me datë 21.12.2017

Zyrtarja ligjore

Ganimete Avdiu

Gjyqtari Individual,

Hakile Ilazi



Këshilla juridike: kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit të Kosovës, në afat prej 15/pesëmbëdhjete/ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, përmes kësaj gjykate.